



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 603/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi - Kryetare, Kimete Gashi Anëtare dhe Agon Ramadani Antarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE): "Sabit Makiqi" B.I(N.P.) "A&V-Collection", me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me uniforma për stafin korrektues", me nr. të prokurimit: 33600-22-5065-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Shërbimi Korrektues i Kosovës me datën, 03.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit), për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me uniforma për stafin korrektues", me nr. të prokurimit: 33600-22-5065-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Shërbimi Korrektues i Kosovës.

2. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 11.10.2022, Shërbimi Korrektues i Kosovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me uniforma për stafin korrektues", me nr.të prokurimit: 33600-22-5065-1-1-1.

Me datë 17.10.2022, Operatori Ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK-Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Me datën 30.12.2022 Operatori Ekonomik "Sabit Makiqi" B.I(N.P.) "A&V-Collection") ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 603/2022, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedura e hapur, lloji i kontratës: Furnizim - kontratë publike kornizë – me një OE, vlera e parashikuar e kontratës: 1,029,460.95 €

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 12.01.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE "Sabit Makiqi" B.I(N.P.) "A&V-Collection") me seli në Prishtinë të aprovet si e bazuar.

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së për aktivitetin e prokurimit të lartë cekur dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Sabit Makiqi" B.I(N.P.) "A&V-Collection").

Përgjigje në Pretendimet OE ankues Nr. 1

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se AK i Shërbimit Korrektues të Kosovës ka vonuar procesin e vlerësimit pa pasur arsyeje pasi kane qene vetëm dy (2) oferta dhe vlerësimi është prej vonuar 25.07.2022 që është bërë hapja deri 11.10.2022 njoftimi vendimit rreth 3 muaj kjo na bon te dyshoj shume! Ku ne baze te kësaj mundem me konstatuar se është shkelur neni 41 Te RRUOPP vlerësimi i ofertave duhet te kryhet me një afat sa me te shkurtër por jo me shume se 30 dite.

Po e citojmë nenin 41 e RRUOPP që bazohet në ligji të prokurimit:

41.2 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 dite pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK sipas procesverbalit të hapjes së ofertave të datës 25.07.2022 të cilën e ka ngarkuar në platformën elektronike e-prokurimi, me pas AK – ZKA me datë: 28.07.2022 nxjerr vendim nr. 867 me të cilin themelon komisionin e vlerësimit prej 5 (pesë) anëtarëve të cilët sipas deklaratave fillojnë punën me datë 01.08.2022, mirëpo AK-ZPP në sqarimin e kërkuar nga ESH dhe përgjigjen nga AK-ZPP ku nuk janë pajtuar me raportin e komisionit të vlerësimit sepse “Komisioni vlerësues në raportin e tyre kanë potencuar se mostrat janë të përafërta me specifikat teknike” dhe AK – ZKA nxjerr vendim me nr. 929 të datës 15.09.2022 ku themelon komisionin e rivlerësimit në përbërje prej 3 (tre) anëtarëve, (të cilët nuk janë profesional sepse në përbërje janë: Kryesuese - Inxh. e Arkitekturës, anëtarë – Udhëheqës i NJ. Juridik në BLS, dhe anëtari tjetër Q.K.F – Lipjan), ndërsa AK me datë me datë 11.10.2022 ngrite në platformën elektronike e-prokurimi B58 - njoftimin vendimi e AK se bashku me B42 – Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, ashtu sikurse është dhënë në raportin e komisionit të Ri-vlerësimit i cili është përgatitur me datë 19.09.2022, kurse është nënshkruar nga anëtarët me datë 07.10.2022, kurse data e nënshkruar nga ZPP mungon, andaj marr për bazë këtë kronologji dhe zhvillim të ngjarjeve nga periudha kur ka ndodhur hapja e ofertave deri në publikimin e B58 – njoftimi mbi vendimin e AK është një periudhë prej 78 ditëve, andaj pavarësisht që nuk kam pranuar nga AK raportin e komisionit të vlerësimit, por vetëm raportin e komisionit të ri-vlerësimit, raport i cili është ngritur në platformën elektronike është një periudhë e gjatë dhe jo me praktiken e mirë pasi që periudha e vlerësimit nuk varet shumë nga divizioni i prokurimit, por nga komisioni i vlerësimit dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 41 të RRUOPP-së, nenit 59 të LPP-së si dhe nenit 7 par. 6 pika (ii) të LPP-së, ku thotë: “publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj”; Duke u bazuar në këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimet OE ankues Nr. 2

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, pran Organit Shqyrtues të Prokurimit në ankesën e tij, tek deklarata detale mbi faktet dhe argumentet, konkretisht pretendimi 2 dhe 4.

Duke pas parasysh se OE ankues në pajtim me nenin 108/A të LPP-së, ka pasur mundësi dhe është dashur që paraprakisht të gjitha pretendimet e veta ti parashtron pran AK, e që në rastin konkret OE ankuese, këtë pretendim nuk e ka parashtruar fare pranë AK me kërkesën për rishqyrtim,

eksperti shqyrtues bazuar ne nenin 109 të LPP-së si dhe paragrafit 9.2 të nenit 9 te dokumentit F03 Rregullat për parashtrim te ankesave-verzioni 2, ku thuhet: "Ankesa do te dorëzohet ne origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit "OSHP" dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato te paraqitura ne Autoritetin Kontraktues" si dhe neni 13 par. 9 i Rregullores së OSHP-së Nr. 01/2020, në të cilën thuhet: "Ankesat duhet të jenë të qarta, e shkurtër, dhe me pretendimet e supozuara që eventualisht janë shkelur nenet e caktuara të LPP-së nga ana e Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore parimisht duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në Autoritetin Kontraktues", andaj nga të cekurat si më lartë pretendimet në fjale nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues.

Përgjigje në Pretendimet OE ankues Nr. 3

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se AK i Shërbimit Korrektues te Burgjeve ka bere shkelje te nenit 59 pasi nuk e ka bere vlerësim real të ofertave pasi sipas ligjit vlerësimi duhet te behet sipas specifikave teknike e jo si që e kanë qe na kane dërguar arsyet për eliminim nga AK na është cekur se nuk janë a testet në përputhje me specifikimet teknike qe një arsyetim është i pa baze dhe këtë gjë kane mundur te bëjnë sqarimet me Laboratorin Euromak Kontrol si qe e parashih nenin 59.2 i LPP-se . Gjithashtu ne mendojmë se te gjitha a testet janë ne përputhje me specifikimin teknik te dosjes se tenderit pasi atestet janë bërë sipas specifikimeve teknike por një arsyetim i tillë nuk qëndron por AK i ka ngatërruar atestet e artikujve .

Arsyet e eliminimit për këmishën sipas AK:

Këmisha taktike me mëngë të shkurtër:

- * Sipas specifikave të AK-së standardi te përmbajtja e materialit është ISO 1833, ndërsa sipas specifikave nga OE-ja, standardi te përmbajtja e materialit është ISO 1833-1.

Këmisha e meshkujve me krahë te shkurtër:

- * Sipas specifikave te AK-se standardi të masa është ISO 3801 PART JU, ndërsa sipas specifikave nga OE-ja, standardi te masa është ISO 3801.

- * Sipas specifikave te AK-se nuk kërkohet rezistenca ndaj konsumit -1000 rrotullime, ndërsa sipas specifikave nga OE-ja, rezistenca ndaj konsumit -1000 rrotullime është paraqitur me rezultat 4.

- * Këmisha e femrave me krahë e shkurte:

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK ka hartuar dhe ngarkuar ne platformën elektronike e-prokurim specifikimin teknik si ne vijim:

Këmisha taktike me mënge te shkurtra

VESSHJE

Materiali kryesor

Pëlhurë këmishë

Karakteristike	Standardi i testimit	Kërkesat
Permbajtja	ISO 1833	65% Poliester / 35% Pamuk / +-3%
Endje	ISO7211-1	RIPSTOP
Numri i fijeve	ISO 7211/2	Warp: 46niti/cm Weft: 19niti/cm
Pesha	ISO 3801 PART III	235 g/m ² +- 3%
Fuqia e keputjes/ N	ISO 13934-1	Length >1350 N Width >480N +-3%
Rezistenca ndaj konsumimit	ISO 13937-1	Warp >= 20 N Weft >= 20 N
Dimensioni i stabilitetit	ISO 5077	Warp < 2 % Weft < 2 %
Rezistenca ndaj konsumimit - 1000 cikle	EN ISO 12945-1	4
Ngjyra Pantone tpx/tpg		Pantone 19-4020 TPG
Rezistenca ndaj ISO4920	ISO4920	100% Waterproof ISO5
Rezistenca e ngjyrës ndaj djersitjes (acid)	EN ISO 105-E04	4
Rezistenca e ngjyrave ndaj djersitjes (alkali)	EN ISO 105-E04	4
Rezistenca e ngjyres ndaj fërkimit të thatë	EN ISO 105-X12	4
Rezistenca e ngjyres ndaj fërkimit të lagësht	EN ISO 105-X12	4
Rezistenca e ngjyres në larje	EN ISO 105-C06	4

MATERIALET TJERA –DIZAJNI

Lloji (shtrirja) e materialit - RIPSTOP

Jakë, mansheta dhe kapakë xhepi duhet të bëhen nga një rresht mesatar (mëngë të vendosura midis pëlhurave) nga materiale që nuk tkurren.

Pullat- Pullat duhet të ketë katër vrima për qepje dhe një ton që përputhet me ngjyrën e materialit.

STILI

Jaka- Jaka duhet të ketë një pamje klasike të modës me pulla. Jaka duhet të qepet 5 mm nga skaji (cepi).

Rripate e shpatullave për Spaleta

Rripat e shpatullave duhet të vendosen mbi shpatulla me dimensione 13.5 cm me 3.5 cm. Çdo rrip shpatullash duhet të përfundojë me një kapëse (pullë), duke pasur kujdes që të vendosni rripat e shpatullave mu në mes të shpatullës, dhe shiritat duhet të mbërthehen 5 mm nga skaji.

Mbërthimi i këmishës- Mbërthimi i këmishës duhet të bëhet së paku me shtatë pulla.


Xhepat -Dy xhepa drejtkëndëshe duhet të arnohen në gjoks. Xhepi duhet të jetë 12 cm i gjerë dhe 15 cm i thellë

Këndet e xhepave janë drejtkëndëshe. Hapja e xhepit ka një madhësi prej 1.5 cm. Në gjoks ka xhepa dhe mbi bazën e këmishës nga shpatullat deri në gjoks ka një gjerësi prej 25 cm dhe përfundon deri në 2 cm nga shiriti i mbërthimit (të pullave). Përforcimi i dimensioneve të (rrethit të xhepit) është minimalisht i dallueshëm, mbi xhepin e anës së majtë duhet të ketë varesë per radiolidhje.

Mëngë-Mëngët duhet të jenë të shkurtra të përkulura 3 cm,

Flamuri i Kosovës, me përmasa 80x50 mm, vendoset në mëngën e djathtë (70 mm nga pjesa e sipërme e mëngës), ndërsa stema e SH.K. K-së vendoset në mëngën e majtë të këmishës (70 mm nga pjesa e sipërme e mëngës).

Mbrapa (shpatulla mbrapa)- Mbrapa (shpatullat) duhet të jenë 8 cm larg nga mesi i qafës. Gjithashtu fundi i skajit duhet të jetë i lakuar.



Këmisha e meshkujve me krahë të shkurte Veshje

Materiali kryesor

Pëlhurë këmishë

Specifika	Standardi	Rezultati
Permbajtja e materialit	ISO 1833	80% pambuk ($\pm 3\%$), 20% poliestër ($\pm 3\%$), trajtimi përfundimtar
Ngjyra Pantone		Pantone 19-4020 TPG
Masa	ISO 3801 PART III	120 g/m ² (± 5 g)
Endje		Pelhure 1/1
Dendësia	ISO 1144:2016	38/34 (prish / endje) tel / cm
Forca thyerëse		58daN/5cm 48daN/5cm
Qëndrueshmëria dimensionale pas larjes në 40 °C	IS 5077	Vertikalno: <2% Horizontalno: <2%
Qëndrueshmëria e ngjyrës në dritë	ISO 105 B02	4-5

Qëndrueshmëria e ngjyrës pas larjes nën 40 ° C	ISO 105 C06	4
Rezistenca e ngjyrës për të mos fërkuar (e thatë)	ISO 105 X12	4
Rezistenca e ngjyrës ndaj konsumimit (e lagur)	ISO 105 X12	4
Rezistenca e ngjyrave ndaj djersës	ISO 105 E04	4

MATERIALET TJERA – DIZAJNI

Lloji (shtrirja) e materialit(anglisht: 1/1 Canvas Tropical)

Jaka, manshetat dhe kapakët e xhepit duhet të bëhen nga një rresht mesatar (mëngë të vendosura midis pëlhurave) nga materiale që nuk tkurren.

PULLAT- Pullat duhet të ketë katër vrima për qepje dhe një ton që përputhet me ngjyrën e materialit.

STILI -Këmisha e prerë në stilin pilot.

JAKA -Jakë duhet të ketë një pamje klasike të modës me pulla. Jaka duhet të qepet 5 mm nga skaji.

Rripat e shpatullave për epauleta -Shiritat e shpatullave duhet të vendosen mu mbi shpatulla me dimesione 13.5 cm me 3.5 cm. Çdo rrip shpatullash duhet të përfundojë me një kapëse (pullë), duke pasur kujdes që të vendosni rripat e shpatullave në mes të shpatullës, dhe shiritat duhet të mbërthehen 5 mm nga skaji.

XHEPI- Dy xhepa drejtkëndëshe duhet të arnohen në gjoks. Xhepi duhet të jetë 12 cm i gjerë dhe 15 cm i thellë.

Mbërthimi i këmishës duhet të bëhet me të paktën shtatë pulla.


Kemisha duhet të ketë fallte 3 cm per mbulimin e pullave .

Mëngët-Mëngët duhet të jenë të shkurtra, të përkulura 3 cm, të qepura 5 mm nga skaji.

Flamuri i Kosovës, me përmasa 80x50 mm, vendoset në mëngën e djathtë (70 mm ngapjesa e sipërme e mëngës), ndërsa stem e SH.K. K-së vendoset në mëngën e majtë të këmishës (70 mm nga pjesa e sipërme e mëngës).

Mbrapa (shpatulla mbrapa) Mbrapa (shpatullat) duhet të jenë 9 cm larg nga mesi i qafës,

Skica



St. Stogovo no. 13 A 1000 Skopje, Macedonia
T: 389 2 3124 322 F: 3126 920 E: j.malk@euromakkontrol.com



EUROMAK KONTROL – INSPECTION DEPARTMENT
QUALITY SUPERINTENDENCE CORPORATION

CERTIFICATE OF QUALITY
No: 010/21

Skopje, 27.04.2021

1. GENERAL DATA

1.1 Name of product:	Tactical Shirt with short sleeves
1.2 Ordering:	Sabit Makipi B.I.; N.P., „A&V-Collection,, Prishtina, R.Kosova
1.3 Producer:	MALBERTEX SHPK
1.4 Date and place of inspection:	05.04.-27.04.2021, Euromak-Kontrol DOO, Skopje
1.5 Sampling:	After delivered sample
1.6 Technical documentation:	Technical documentation from the Tender specification: "supply of uniforms for correctional staff".

2. SUBJECT OF INSPECTION

2.1 Quality and visual inspection of Tactical Shirt with short sleeves
upon submitted sample.

3. INSPECTION REPORT-visual inspection of The main material-Shirt fabric

3.1 Other materials-design:	Lining (RIPSTOP) Collars, cuffs and pocket caps is made of a medium row (sleeves placed between the fabrics) from materials that do not shrink.
3.2 Stamps:	The stamps have four holes for sewing and a tone that matches the color of the material.
3.3 Collar:	The collar have a classic fashion look with stamps. The collar is be sewn 5 mm from the edge.
3.4 Epaulette shoulder straps:	Shoulder straps are shown at the top. 13.5 cm by 3.5 cm. Each shoulder strap are finished with a clamp, taking care to place the shoulder straps in the middle of the shoulder, and the straps are fastened 5 mm from the edge.
3.5 Fasten the money:	Shirt locking is with seven buttons.
3.6 Pockets:	Two rectangular pockets are patched to the chest. The pocket is 12 cm wide and 15 cm deep. The corners of the pockets are rectangular. The pocket opening has a size of 1.5 cm. There are pockets on the chest and on the base of the shirt from the shoulders to the

This inspection has been carried out to the best of our knowledge and conscience and this certificate does not absolve the seller and the buyer from their contractual responsibilities. In case of quality superintendence or inspection of goods we are responsible in accordance with the deed contract, in case of taking over of goods in accordance with principles of power of attorney, while for weight and quality quarantine transactions we are responsible in accordance with the stipulations of contracts concluded relative to such transactions

1/3

	chest there is a width of 25 cm and ends 2 to cm from the fastening tape. The reinforcement of the minimum dimensions is saturated, on the left side pocket have a hanger for radio connection.
3.7 Crock:	Sleeves are short bent 3 cm. The flag of Kosovo, measuring 80x50 mm, is placed on the right sleeve (70 mm from the upper part of the sleeve), while the SCA emblem is placed on the left sleeve of the shirt (70 mm from the upper part of the sleeve). Back (shoulders back) The back (shoulders) is a 8 cm away from the middle of the neck. Also the end of the skirt is a curved.

4. Quality Inspection

Parameters	Methods	Results
SHEET - Main material - Shirt fabric		
Material composition (%)	ISO 1833	Cotton:35% Polyester:65%
Weave	ISO7211-1	Ripstop
Number of threads	ISO 7211-2	Warp: 46 niti/cm Weft: 19 niti/cm
Weight (gm ²)	ISO 3801 PART III	235 g/m ²
Breaking power / N	ISO 13934-1	Length 1350 N Width 480 N
Consumption resistance	ISO 13937-1	Warp 20 N Weft 20 N
Dinansional Stability	IS 5077	Vertical: 1% Horizontal:1%
Consumption resistance - 1000 cycles	EN ISO 12945-1	4
Color Pantone tpx / lpg	/	Pantone 19-4020 TPG
Resistance to ISO4920	ISO4920	100% Waterproof ISO5
Color resistance to sweat (acid)	EN ISO 105-E04	4
Dye resistance to sweat (alkali)	EN ISO 105-E04	4

This inspection has been carried out to the best of our knowledge and conscience and this certificate does not absolve the seller and the buyer from their contractual responsibilities. In case of quality superintendence or inspection of goods we are responsible in accordance with the used contract, in case of taking over of goods in accordance with principles of power of attorney, while for weight and quality quarantine transactions we are responsible in accordance with the stipulations of contracts concluded relative to such transactions

2/3

Paint resistance to dry friction	EN ISO 105-X12	4
Resistance of paint to wet friction	EN ISO 105-X12	4
Color resistance in washing	EN ISO 105-C05	4

5. CONCLUSION

On the basis of the performed inspection, we have concluded that the above mentioned subject Tactical Shirt with short sleeves is in accordance with requirements of Technical documentation from the Tender specification "supply of uniforms for correctional staff".

Approved by: 
Technical manager

This inspection has been carried out to the best of our knowledge and conscience and this certificate does not absolve the seller and the buyer from their contractual responsibilities. In case of quality superintendence or inspection of goods we are responsible in accordance with the used contract, in case of taking over of goods in accordance with principles of power of attorney, while for weight and quality quarantine transactions we are responsible in accordance with the stipulations of contracts concluded relative to such transactions

3/3



st. Stogovo no. 13 A 1000 Skopje, Macedonia
T: 300 2 3124 322 F: 3126 020 E: mail@euromakcontrol.com



EUROMAK KONTROL – INSPECTION DEPARTMENT
QUALITY SUPERINTENDENCE CORPORATION

CERTIFICATE OF QUALITY
No: 011/21

Skopje, 27.04.2021

1. GENERAL DATA

- 1.1 Name of product:** Men's shirt with short sleeves
Sabit Makiqi B.I.;
N.P., „A&V-Collection,,
Pristina, R.Kosova
- 1.2 Ordering:** MALBERTEX SHPK
05.04.-27.04.2021, Euromak-Kontrol
DOO, Skopje
- 1.3 Producer:** After delivered sample
- 1.4 Date and place of inspection:** Technical documentation from the
Tender specification: "supply of
uniforms for correctional staff".
- 1.5 Sampling:**
- 1.6 Technical documentation:**

2. SUBJECT OF INSPECTION

- 2.1** Quality and visual inspection of Men's shirt with short sleeves upon submitted sample.

3. INSPECTION REPORT-visual inspection of The main material-Shirt fabric

3.1 Other materials-desing:	(English: 1/1 Canvas Tropical) Collars, cuffs and pocket caps is made of a medium row (sleeves placed between the fabrics) from materials that do not shrink.
3.2 Stamps:	The stamps have four holes for sewing and a tone that matches the color of the material.
3.3 Collar:	The collar have a classic fashion look with stamps. The collar is be sewn 5 mm from the edge.
3.4 Epaulette shoulder straps:	Shoulder straps are shown at the top. 13.5 cm by 3.5 cm. Each shoulder strap are finished with a clamp, taking care to place the shoulder straps in the middle of the shoulder, and the straps are fastened 5 mm from the edge.
3.5 Fasten the money:	Shirt locking is with seven buttons.
3.6 Pockets:	Two rectangular pockets are patched to the chest. The pocket is 13 cm wide and 14 cm deep. The corners of the pockets are rectangular. The pocket opening has a size of 1.5 cm. There are pockets on the chest and on the base of the shirt from the shoulders to the chest there is a width of 25 cm and ends 2 to cm

This inspection has been carried out to the best of our knowledge and conscience and this certificate does not absolve the seller and the buyer from their contractual responsibilities. In case of quality superintendence or inspection of goods we are responsible in accordance with the deed contract, in case of taking over of goods in accordance with principles of power of attorney, while for weight and quality quarantine transactions we are responsible in accordance with the stipulations of contracts concluded relative to such transactions

1/3

3.7 Creak:	from the fastening tape. The reinforcement of the minimum dimensions is saturated, on the left side pocket have a hanger for radio connection. Sleeves are short bent 3 cm, sewn 5 mm from the edge and under the sleeve of the shirt there is a ventilation opening, the diameter of which is 3-4 mm. The hole is places 3 cm from the arm. The flag of Kosovo, measuring 80x50 mm, is placed on the right sleeve (70 mm from the upper part of the sleeve), while the SCA emblem is placed on the left sleeve of the shirt (70 mm from the upper part of the sleeve). Back (shoulders back) The back (shoulders) is a 9 cm away from the middle of the neck.
3.8 Edge	The end of the skirt is a curved.

4. Quality inspection


Parameters	Methods	Results
SHEET - Main material - Shirt fabric		
Material composition (%)	ISO 1833-1	Cotton:80% Polyester:20%
Color Pantone	/	Pantone 19-4020 TPG
Weave		fabric 1/1
Weight (gm ²)	ISO 3801	120 g/m ²
Density	ISO 1144:2016	38/34 (break / weave) tel / cm
Fracture force	/	58daN/5cm 48daN/5cm
Dimensional stability after washing at 40°C	ISO 5077	Vertical: 1% Horizontal: 1%
Color fastness to light	ISO 105 B02	4-5
Color fastness after washing below 40°C	ISO 105 C06	4
Paint resistance not to rub (dry)	ISO 105 X12	4
Paint resistance to wear (wet)	ISO 105 X12	4
Color resistance to sweat	ISO 105 E04	4

This inspection has been carried out to the best of our knowledge and conscience and this certificate does not absolve the seller and the buyer from their contractual responsibilities. In case of quality superintendence or inspection of goods we are responsible in accordance with the deed contract, in case of taking over of goods in accordance with principles of power of attorney, while for weight and quality quarantine transactions we are responsible in accordance with the stipulations of contracts concluded relative to such transactions

2/3

6. CONCLUSION

On the basis of the performed inspection, we have concluded that the above mentioned subject Men's shirt with short sleeves is in accordance with requirements of Technical documentation from the Tender specification "supply of uniforms for correctional staff".

Approved by:

 Technical manager

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, se AK- Komisioni i vlerësimit ne raportin e vlerësimit tek deklarata, jep këtë arsyetim si ne vijim:

Këmisha e meshkujve me krahë të shkurtër:

* Sipas specifikave të AK-së, xhepi duhet të jetë 12 cm l gjërë dhe 15 cm l thellë, ndërsa sipas specifikave nga OE-ja xhepi është 13 cm l gjërë dhe 14 cm l thellë.

* Sipas specifikave të AK-së standardi te përmbajtja e materialit është ISO 1833, ndërsa sipas specifikave nga OE-ja, standardi te përmbajtja e materialit është ISO 1833-1.

Komisioni i vlerësimit me rastin e arsytimit të eliminimit se AK ka specifikuar apo kërkuar në dosje tenderit standardin ISO 1833, kurse OE ankues ka sjellë standardin ISO 1833 -1, duke marr për bazë se specifikimi teknik – aneksi 1 të dosjes se tenderit (AK ka publikuar ne platformën elektronike të gjithë specifikimin teknik) te cilat janë hartuar para disa viteve dhe modifikuar kohe pakohe deri me rastin e publikimit, (pasi qe disa vite SHKK tenderon uniforma për staf), atëherë kjo i bie qe AK nuk do të mund te zgjedhe asnjëherë, prandaj konsideroj se pavarësisht Standardi ISO 1833, ky ISO Standard i ka edhe 80 pjese tjera varësisht nga avancimet teknologjike – botimet e fundit i dokumentit të referuar - duke përfshirë çdo përmirësim sipas ISO 1833-1, Tekstile - Analiza kimike sasiore), mirëpo këta numra janë brenda i këtij standardi nuk e përjashton - linku për informacione: <https://www.iso.org/obp/ui/#iso:std:iso:1833:-1:ed-2:v1:en>, prandaj komisioni i vlerësimit duhet te merr për bazë standardin ISO 1833 dhe jo te diskualifikoj OE ankues lidhur me këtë arsyetim, pavarësisht kësaj bazuar ne raportin e raportin e rivlerësimit i cili është nënshkruar me datë 07.10.2022, komision nëse ka pas paqartësi (dhe sigurisht ka pasur) ka qenë i obliguar të vepronte sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, duke ju drejtuar OE ankues apo edhe Laboratorit Euromak Kontrol, Shkup - Maqedonia Veriore, nga i cili janë bërë inspektimet.

Gjithashtu, Eksperti Shqyrtues sqaron se lidhur me arsyetimin e matjeve te mostrave i cili vlerësimi është në diskrecion të AK – komisionit të vlerësimit dhe duke u bazuar nga raporti ku prezantohen disa fotografi që ka bërë matjet, konsideroj mjeti matës (metra duhet të jetë e drejt e pa lakueshme gjate matjes se uniformave si dhe tekstili të jetë i zgjatur mjaftueshëm) për gjatësi nuk ka qenë adekuat po ashtu edhe matja nuk ka qenë në pozicione të drejta të rrafshëta dhe profesional, pasi qe këtu kemi të bëjmë me matje të gjatësisë me cm, prandaj konsideroj për të gjitha arsyetimet e dhëna nga komisioni i vlerësimit në raport lidhur me matjet e gjatësisë se tekstilit nuk janë bërë ne mënyrën si duhet me matje profesional dhe me mjete adekuate profesionale (dëshmi se matjet nuk janë të sakta janë fotot e prezantuar në raportin e komisionit të vlerësimit), Prandaj, duke marr për bazë se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve është në diskrecion të AK- Komisionit të vlerësimit, i cili e ka mund të trajtoj sipas nenit 59 par. 4 pika (ii) të LPP-së, po citoj: “përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”, të gjitha dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë aktivitet të prokurimit, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës si dhe duke marr për

bazë interesin publik, konkretisht furnizimin me uniforma si të nevojshme dhe të domosdoshme për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të stafit të SHKK. Duke u bazuar në këto fakte të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika janë të qëndrueshëm.

ESH të njëjtin mendim ndan edhe për pretendimet tjera OE dhe arsyet e tjera të eliminimit të deklarata në raportin e vlerësimit.

Përgjigje në Pretendimet OE ankues Nr. 4

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se Epoleta është kërkuar Xhakete dimri:

Shiritat e epoletave duhet të kenë madhësi 13.5 x 4 cm. Çdo paletë duhet të përfundojë me një buton shtypës të papërshkueshëm nga uji, i bashkangjitur në pjesën e poshtme të pëlhurës së shiritit të paletës. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rripave të krahëve (për epauleta) e që duhet të jenë të vendosura mu mbi krah. Hapja efektive duhet të jetë 13 cm. Gjithashtu as arsyet e eliminimit të xhemperit nuk qëndrojnë në specifikim teknik të dosjes është kërkuar:

E poletave me gjatësi 13.5 cm dhe për bërrylat me dimension 10x21.5cm

Ndërsa shikojë foton e OE A&V Collection NP gjatësia 13.5 cm, ndërsa hapja efektive është 13 pra nuk qëndron arsyeja e eliminimit pra edhe këtu shihet se arsyet e eliminimit nuk qëndrojnë dhe kjo konsiderohet shkelje shumë e rëndë e LPP-se. Të gjitha këto arsye nuk janë bërë matjet e mostrave mire dhe AK ka të drejtën të dërgoj në Laborator për të sqaruar të gjitha dilemat që kanë lidhur me specifikimin teknik.

Gjithashtu, Eksperti Shqyrtues sqaron se lidhur me arsyetimin e matjeve të mostrave i cili vlerësimi është në diskrecion të AK – komisionit të vlerësimit dhe duke u bazuar nga raporti ku prezantohen disa fotografi që ka bërë matjet, konsideroj mjetin matës (metra duhet të jete e drejtë e pa lakueshme gjatë matjes së uniformave si dhe tekstili të jete i zgjatur mjaftueshëm) për gjatësi nuk ka qenë adekuat po ashtu edhe matja nuk ka qenë në pozicione të drejta të rrafshëta dhe profesional, pasi që këtu kemi të bëjmë me matje të gjatësisë me cm, prandaj konsideroj për të gjitha arsyetimet e dhëna nga komisioni i vlerësimit në raport lidhur me matjet e gjatësisë së tekstilit nuk janë bërë në mënyrën si duhet me matje profesionale dhe me mjete adekuate profesionale (dëshmi se matjet nuk janë të sakta janë fotot e prezantuar në raportin e komisionit të vlerësimit), Prandaj, duke marrë për bazë se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve është në diskrecion të AK – Komisionit të vlerësimit, i cili e ka mundësinë të trajtoj sipas nenit 59 par. 4 pika (ii) të LPP-së, po citoj: “përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundur, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”, të gjitha dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë aktivitet të prokurimit, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës si dhe duke marrë për bazë interesin publik, konkretisht furnizimin me uniforma si të nevojshme dhe të domosdoshme

për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të stafit të SHKK. Duke u bazuar në këto fakte të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika janë të qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimet OE ankues Nr. 5

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se kompania jone Sabit Makiqi B.I. A&V Collection NP nuk pajtohet as me arsyet e eliminimit për pantallona, nuk pajtohem me arsyet e eliminimit xhakete verore, nuk pajtohem me arsyet e eliminimit kapele verore, dimërore, nuk pajtohem me arsyet e eliminimit kapela për udhëheqës meshkuj, nuk pajtohem me arsyet e eliminimit kravata, nuk pajtohem me arsyet e eliminimit xhaketa solemne, nuk pajtohem me arsyet e eliminimit kapela solemne për meshkuj që janë dërguar në Njoftimi mbi Vendimin e AK të datës 11.10.2022 pasi i përmbushim të gjitha specifikat teknike të kërkuara në dosjen e tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmi të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, sqarimeve të kërkuara nga ESH drejtuar AK lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, nuk ka respektuar nenin 7, 59, 62, 72 të LPP-së, andaj, Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP-se, në këtë aktivitet të prokurimit, në mënyrë që të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 në dosje të tenderit si dhe të respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të këtë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

-Konstatimet e Panelit Shqyrtues-

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor më datë 01.03.2023 me qëllim të vlerësimit të drejtë të çështjes. Pohimet e palëve, provat e administruara dhe shpjegimet e ekspertit janë evidentuar në procesverbalin e kësaj seance, të cilat në këtë rast për nevojat e këtij vendimi konstatohet (shkurtimisht) se, të dyja palët kanë qëndruar prapa pretendimeve të tyre. Përveç, ekspertit shqyrtues i cili deklaroi “se me rastin e hartimit të ekspertizës nuk i kam analizuar atestet e laboratorit të OE ankues dhe me kundërshtimin e bërë nga AK në raportin e ekspertizës ku i bashkëngjit këto dëshmi dhe që nuk janë në harmoni me specifikimin teknik, unë e ndërroj mendimin sepse atestet nuk janë sipas specifikacionit teknik, andaj pajtohem me deklaratën e AK-së që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së”.

Pas analizimit të të gjitha shkresave dhe provave të prezantuara nga palët edhe përmes email-ve, PSH konstaton se bazuar në atestet e lëshuara nga laborator i certifikuar me të cilat ka ofertuar OE ankues nuk janë në harmoni me specifikat e Dosjes së Tenderit të vendosura nga ana AK dhe nuk janë të lejuara përqindjet e devijimeve. Andaj, AK me të drejtë bënë anulimin e aktivitetit të prokurimit në mungesë të ofertave të cilat nuk kanë plotësuar specifikimet teknike të detyrueshme.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe rrjedhën e procedurës, Paneli konstatoi se pretendimet kryesore mbi bazën e të cilave është ushtruar ankesa, i referohen në fakt njoftimit mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit mbi bazën e plotësimit të specifikave teknike të detyrueshme.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 59, të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Në ndajshesë të lartcekurave, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK

në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Vëdat POTEROQI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Shërbimi Korrektues i Kosovës

1x1OE "Sabit Makiqi" B.I(N.P."A&V-Collection"), me seli në Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.